



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Dorezuar Primijsno/Prodato Received/Delivery	25.05	2022	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMS/HCK	3045/2022		114



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.310/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.310/2022 të datës 29.03.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë

Komuna e Fushë Kosovës, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike „kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 25.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. **Detyrohet** Komisioni për Grada dhe Disiplinë i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të bëjë rishqyrtimin e kërkesës për gradim të datës 07.09.2021 të parashtruar nga ankuesi pranë Komisionit për Grada dhe Disiplinë, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.

II. **Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që ti ndër marr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që zbatimi i këtij vendimi të bëhet brenda afatit të përcaktuar në pikën I të tij.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Jashtme me datë 14.04.2022 ka bërë ftesë për shprehje të interesit për gradim duke u mbështetur në nenin 30 të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm me Nr.03/L-122 duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 4 dhe nenin 14 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores



Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm kështu duke i njoftuar kandidatët se Komisioni për Grada dhe Disiplinë do të mbledhet me datë 10.09.2021 dhe se në mbështetje të kriterëve ligjor për avancim do të shqyrtoj kërkesat për gradim.

Ankuesi me datë 07.09.2021 ka parashtruar kërkesë për gradim nga grada Sekretar i II-të në gradën Këshilltar në Komisionin për Grada dhe Disiplinë pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës kështu duke bashkangjitur dosjen e tij me dokumentacionin përcjellës.

Ankuesi i pa kënaqur me mos ngritje në gradë, me datë 07.07.2022 ka parashtruar kërkesën për qasje në dokumente publike, e cila kërkesë ankuesit iu është aprovuar me Vendim Nr.84/2022 të datës 15.03.2022 të Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punës së Jashtme dhe Diasporës.

Ankuesi nëpërmjet e-mail-it zyrtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 29.03.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1671/2022 me pretendim ankimor për mos dhënien e gradës diplomatike.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pas kërkesës së Kryetares së Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nxjerr vendimin VK.Nr.44/2022 të datës 12.05.2022 për zgjatjen e afatit për vendimmarrje edhe për dhjetë (10) ditë pune për ankesën me numër A.nr.310/2022 të datës 29.03.2022 pasi që ka nevojë për shqyrtim të mëtejme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 05.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa me datë 14.04.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankese së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/20.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 29.03.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa e datës 07.03.2022 për çasje në dokumente publike; Vendimi i datës 15.03.2022; e-mail i datës 17.03.2022; Kërkesa e datës 07.09.2021 për gradim; Aplikacioni i ankuesit; Letër motivimi i datës 07.09.2021; vendimi i datës 24.07.2018; Vendimi i datës 30.04.2014; Vendimi i datës 18.04.2014; Përgjigja në ankese e datës 23.07.2014; Formulari i vlerësimit të punës për vitin 2013; 2019; 2020; Akt emërimi me numër 096; Ndryshim plotësimi i akt emërimi me numër 096/2014; Vendimi i datës 01.10.2020; Vendimi i datës 09.12.2020; E-mail i datës 14.04.2022; përgjigja në ankese nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës e datës 14.04.2022 si dhe provat shtesë nga organi i punësimit të datës 23.05.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1.4 të Ligjit 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar që ekziston baza ligjore për të vendosur, duke obliguar organin e punësimit,

respektivisht, Komisionin për Grada dhe Disiplinë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që ti ndërmarr të gjitha veprimet, për të vendosur lidhur me rishqyrtimin e kërkesës së datës 07.09.2021 të parashtruar nga ankuesi drejtuar Komisionit për Grada dhe Disipline, pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, sipas shkresave të lëndës ka gjetur se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datë 14.04.2022 ka bërë ftesë për shprehje të interesit për gradim duke u mbështetur në nenin 30 të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm me Nr.03/L-122 duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 4 dhe nenin 14 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm kështu duke i njoftuar kandidatët se Komisioni për Grada dhe Disiplinë do të mbledhet me datë 10.09.2021 dhe se në mbështetje të kriterëve ligjor për avancim do ti shqyrtoj kërkesat për gradim.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka gjetur se Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme me Vendimin me numër të referencës 471/2021 të datës 01.12.2021 ka bërë emërimin e anëtarëve të Komisionit për Gradim dhe Disiplinë prej shtatë (7) anëtarëve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës konkretisht Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit për Grada dhe Disiplinë të mbajtur me datë 08.12.2021 ka konstatuar se prej shtatë (7) anëtarëve të Komisionit prezent në këtë takim kanë qenë gjashtë (6) anëtarë Kryesuesja e Komisionit dhe pesë (5) anëtarë të tjerë. Gjithnjë duke u bazuar në procesverbalin e mbledhjes së datës 08.12.2021, Kolegji ka konstatuar se Komisioni për Grada dhe Disiplinë e ka shqyrtuar aplikacionin e ankuesit dhe se ky Komision ka konstatuar se ankuesi i ka plotësuar kriteret teknike për gradim dhe pas hedhjes së propozimit në votim për ngritjen për një gradë nga Sekretar i dytë në gradën Sekretar i parë rezultati i votimit ishte: tre (3) anëtarë votuan pro, asnjë kundër dhe tre (3) abstenime, mirëpo në procesverbal nuk është konstatuar fare se a aprovohet apo refuzohet gradimi i ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka analizuar dispozitat ligjore përkatësisht nenin 42 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku është përcaktuar se: *"1. Vendimet e organit kolegjal merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Vendimet me procedurë qarkulluese merren me shumicën e votave të anëtarëve të organit kolegjal. 2. Abstenimi apo votat e paplotësuara do të llogariten si vota kundër "* 3. *Në rast barazie të votave, vota e kryetarit është vendimtare, përveçse kur ai ka një pengesë ligjore për të votuar sipas ligjit."*, me qëllim të vërtetimit të drejte të gjendjes faktike Kolegji nëpërmjet e-mail-it zyrtarë me datë 19.05.2022 ka kërkuar prova shtesë nga organi i punësimit me theks të veçantë ka kërkuar që të njoftohet se Kryesuesja e Komisionit për Grada dhe Disiplinë a e ka përdorur/shfrytëzuar veton e saj me rastin e votimit të kandidatit dhe se me datë 20.05.2022 jemi njoftuar se Kryesuesja e Komisionit për Grada dhe Disiplinë është deklaruar për rritjen e gradës diplomatike të andaj bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se sipas procesverbalit të datës 08.12.2021 me rastin e shqyrtimit të aplikacioneve të kandidatëve tjerë për gradim pas votimit Komisionit për Grada dhe Disiplinë ka konstatuar se a kalon apo jo gradimi i kandidatëve ndërsa në rastin konkret të ankuesit Komisioni për Grada dhe Disiplinë nuk ka dhënë fare konstatim lidhur me gradimin apo mos gradimin



andaj Kolegji konstaton Komisioni për Grada dhe Disiplinë, është kompetent për shqyrtimin e kërkesave për gradim dhe se është i obliguar të vendosw për aprovimin apo refuzimin e gradimit.

Andaj, duke marr parasysh rrethanat si me lartë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se pas pranimit të Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, organi i punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Komisioni për Grada dhe Disiplinë, duhet të rishqyrtojë kërkesën e ankuesit te datës 07.09.2021 si dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjin Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.310/2022

Valentina Kaçaniçolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.